



Drejtuar: Operatorit Ekonomik “M.A.K” shpk

Adresa: Njësia Bashkiake nr.5,Rruga “Irfan Tomini”,pallati i shoqerise Cani nr.1, kati i I, Tirane.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rikonstruksioni i tre fushave sportive në shkollën 9-vjecare “Katund i ri” dhe Shkollën e mesme ”Sadik Stavileci”

Nr. References: 87197-09-25-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është **Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rikonstruksioni i tre fushave sportive në shkollën 9-vjecare “Katund i ri” dhe Shkollën e mesme ”Sadik Stavileci”**, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

Fondi limit: 133.645 (Njëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion nga Kontrata e Grantit 07 datë 13.07.2018, ndërmjet Fondacionit ”Programi i Zhvillimit Rajonal Shqipëri” dhe Bashkisë Tiranë. me objekt: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rikonstruksioni i tre fushave sportive në shkollën 9-vjecare “Katund i ri” dhe Shkollën e mesme ”Sadik Stavileci”

Kohëzgjatja e kontratës: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve, 3 (tre) muaj.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 08.10.2018, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 39 datë 01.10.2018.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Novatech Studio” shpk me nr.**

NIPTI L01717030C

Vlera e ofertës = **118 037** (njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e shtatë) **lekë**.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “M.A.K Studio” shpk me nr. NIPTI L014220170

Vlera e ofertës = **113.358** (njëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) **lekë**.

3. Oferta e paraqitur nga Operatorit Ekonomik “Rean – 95” shpk me nr. NIPTI J61827043V

Vlera e ofertës = **121.975** (njëqind e njëzet e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) **lekë**.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “Rean-95” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Operatori Ekonomik “REAN-95” shpk *nuk plotëson pikën 2.2, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ / Kapaciteti teknik, si më poshtë vijon, pika 2.2, nënpika 1:*

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- 1. Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 53.458 (pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.*

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.*
- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).*

Operatori Ekonomik "Rean-95" shpk, në përmbushje të kriterit të lartpërmendur, ka paraqitur në sistemin elektronik të App-së , **si shërbim të ngjashëm kontratën me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tepelenë, me numër 001/1ref datë 24.08.2016, me objekt: "Mbi kolaudimin e punimeve për objektin "Rikonstruksion i Gjimnazit Abaz Shehu" Tepelenë"**. Operatori Ekonomik "Rean-95" shpk , në përmbushje të kriterit të lartpërmendur ,duhet të paraqiste si shërbim të ngjashëm, kontratë mbikqyrje dhe jo kolaudimi.**Sa me sipër cituar, Operatori Ekonomik "Rean-95" shpk, nuk plotëson pikën 2.2, nën-pikën (1,) Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.**

Janë shpallur si ofertues të suksesshëm:

- **Operatori Ekonomik Operatori Ekonomik "M.A.K Studio" shpk, kualifikohet në vend të parë.**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **113.358** (njëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) **lekë.**

Çmimi total i ofertës me tvsh = **136.030** (njëqind e tridhjetë gjashtëmijë e tridhjetë) **lekë.**

Afati kohor për realizimin e shërbimit është nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve 3 (tre) muaj.

- **Operatori Ekonomik "Novatech Studio" shpk, kualifikohet në vend të dytë.**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **118 037** (njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e shtatë) **lekë.**

Çmimi total i ofertës me tvsh = **141.644** (njëqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) **lekë.**

Afati kohor për realizimin e shërbimit është nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve 3 (tre) muaj.

- **Skualifikohet për arsyet e sipërcituara Operatori Ekonomik si më poshtë:
"Rean-95" shpk**

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 16.10.2018

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik "M.A.K"**

shpk, me nr. NIPTI **L014220170**, me adresë: Njësia Bashkiake nr.5,Rruga “Irfan Tomini”,pallati i shoqerise Cani nr.1, kati i I, Tirane, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme = **113.358** (njëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) **lekë**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

